

Lënda: **Gjuhe Angleze I DHE Gjuhe Angleze II**

Informatat themelore për lëndën		
Njësia Akademike:	Fakulteti i Filologjisë, Departamenti i Gazetarisë	
Titulli i lëndës:	Anglisht I dhe Anglisht II	
Niveli:	Bachelor	
Statusi i lëndës:	Obligative	
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I dhe II	
Numri i orëve në javë:	2 + 0 për grup	
Kredit - ECTS:	4	
Koha / vendi:	Të hënave; 14:00-15:30' 15:30-17:00 Departamenti i Gazetarisë	
Ushtrime:	0	
Të dhënat e kontaktit:	Sadetete.ternava@uni-pr.edu	
Përshkrimi i lëndës:	Kjo lëndë zhvillon aftësi komunikimi përmes përvetësimit të aftësive themelore gjuhësore së bashku me aftësitë studimore. Lënda e gjuhës angleze gjatë vitit të parë të studimeve prezanton gjithashtu gramatikën, por me teknika të reja brenda qasjes komunikative dhe të të nxëniet të integruar të përmbajtjes dhe gjuhës (CLIL), ku studenti ka fokusin qendror. Literatura përbëhet nga module të ndara, nga jeta e përditshme e njerëzve dhe kulturave të ndryshme, por e fokusuar më shumë në kulturën autentike anglisht-folëse, e përmbledhur në një numër të konsiderueshëm njësish brenda tekstit kryesor (On Screen-B2+ Student's dhe Workbook), e që mbulohet gjithashtu nga tema të gazetarisë në anglisht.	
Objektivat e lëndës:	Ligjëratat kanë për qëllim t'i aftësojnë studentët në disa forma: Të kuptojnë dhe t'i përdorin katër aftësitë për të komunikuar me të tjerët përmes prezantimeve me qëllim të caktuar. Të bëjnë krahasime të gjuhës angleze në korrelacion me shqipen (përmes ushtrimeve interaktive të gramatikës për të kuptuar ndryshimet dhe analogjitë gjuhësore midis anglishtes dhe gjuhës amtare). Të fitojnë njohuri mbi gramatikën duke mësuar dhe praktikuar gramatikën në kontekstin e ndërtimit logjik, qoftë me gojë apo me shkrim, dhe ta mësojnë atë të jetë sa më natyrale në mënyrë që të bëhen mendimtarë kritikë.	

Rezultatet e pritshme të lëndës:	Pas përfundimit të kësaj lënde, studentët pritet të zhvillojnë kapacitetet dhe të fitojnë njohuri të përgjithshme mbi të përvetësuarit e gjuhës angleze bazuar në katër aftësitë bazë gjuhësore: dëgjimin, shkrimin, leximin dhe të folurit, dhe këto aftësi t'i aplikojnë në përditshmëri. Qëllimi kryesor është të mundësohet që studentët të shprehen në mënyrë efektive dhe të qartë në gjuhën angleze për arritje të mëtejshme profesionale
---	--

	Ngarkesa e studentit
--	-----------------------------

Aktiviteti	Orë	Ditë/Javë	Totali
Ligjërata	2	15	30
Kontakti me mësimdhënësen/ konsultime	10 min	15	2.5
Kollokfiume, seminare	8	1	8
Detyra shtëpie	1	15	15
Vetë-studim (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	15	15
Përgatitje për provimin final	10	1	10
Kohë e kaluar në vlerësim (teste, kuize, provime)	3	2	6
Projekte, prezantime etj.	30 min	1	0.5
	1	15	15
Total			102 ore = 4 ECTS

Metodologjia e mësimdhënies:	Gjuha Angleze I dhe II janë lëndë praktike-teorike me nivel të mesëm deri të avancuar me metodologjinë komunikuese. Libri bazë përmban tetë module kryesore mësimore me tema të ndryshme; çdo temë zhvillohet në bazë të nivelit dhe interesit të studentëve për të mësuar anglishten dhe kjo zërthehet përmes metodologjisë CLIL. Fjalori dhe shprehjet e veçanta do të përfshihen si teknikë në situata tematike brenda fushës së gazetarisë. Duke marrë parasysh që të shkruarit dhe leximi në gjuhën angleze janë në vetvete sfiduese do të bëhen përpjekje të veçanta për të ndihmuar studentët në arritjen e njohurive përkatëse. Në këtë drejtim, lloje të veçanta të leximit do të përfshihen për të ndihmuar në analizën dhe prezantimin e stileve të ndryshme të komunikimit në gjuhën angleze. Detyrat shitesë brenda ligjëratave dhe ato të shtëpisë do të ndihmojnë në një vlerësim më të mirë të nevojave dhe të nivelit të studentëve.
-------------------------------------	---

Mënyra e vlerësimit:	10% 10% 20% 60% 100%	Pjesëmarrja e rregullt Detyra (shtëpie/klase) Vlerësimi intermediar Testi final Totali
Literatura themelore:	On Screen Upper intermediate B2+ student's and work book B2+; Writing Book B2+ Virginia Evans- Jenny Dooley, Express Publishing English For Journalists –Wyndord Hicks –edicioni i tretë	
Literatura shtesë:	Teaching Written English Ronald V. White Grammar Practice Activities; -Penny Ur Fjalor Anglisht – Shqip dhe Shqip – Anglisht Oxford English Dictionary The A-Z of Correct English –Angela Burt The Teacher's Grammar Book-James D. Williams	

Plani i detajuar ENGLISH I	
Java	Njësitë
Java I:	Hyrje – pritshmëritë
Java II:	Përmbledhje mbi katër shkathtësitë bazë gjuhësore
Java III:	Moduli: Kohët/Fjalori për profesione; dëgjimi aktiv; idiomat; fraza foljore; ripërsëritje & diskutim
Java IV:	Moduli 1 – kuptimi i pjesës se lexuar; kohët e tashme; shprehjet e përditshme; biseda për situata specifike; përdorimi fjalorit specifik; diskutim
Java V:	Moduli 2 – Temat mbi Udhëtimet dhe blerjet; tekste për programe radioje; tekste për stil jetese; shkrimi i email-it; diskutim & komente
Java VI:	Story telling/ përmes prezantimeve në grupe, fokusi në kohët e shkuara; dëgjimi aktiv & të folurit; si shkruhen aplikimet për punë
Java VII:	Fjalor specifik / video për media; prezantime në grup; diskutim & komente
Java VIII:	Përdorimi / mungesa e nyjeve në tituj; teksti: Çfarë dëshironi të bëni dhe bëheni?; shtimi i CV-ve, letrave motivimuese, organizimi strukturor dhe gjuhësor
Java IX:	Moduli 3 – Tekst: Bota jonë: te shprehurit lidhur me çështje sociale, fatkeqësi natyrore; Si shkruhen esetë; struktura e paragrafëve; lidhëset logjike; prezantim individual

Java X:	Teksti: Gjuha e Reklamave; përshkrime produkte; shkrim, lexim, të folur; ushtrime në grup
Java XI:	Prezantime në grup; teksti: Çfarë ka rëndësi; përdorimi i mbiemrave për shfaqje të mendimeve; ushtrime dhe përsëritje përkatëse
Java XII:	Moduli 4 – Teksti: Gjendje shpirtërore; përshkrimi i ndjenjave; terminologji specifike e gazetarisë për intervista
Java XIII:	Testi intermediar
Java XIV:	Lexim i pavarur dhe teknikat e rrëfimit; tekste për shëndetin dhe stresin; fjalor tematik psikologjik
Java XV:	Fjalor tematik psikologjik nëpërmjet përdorimit përkatës gjuhesor; formimi i fjalëve; përsëritje e moduleve 1–4; përgatitje për provim
Plan i detajuar	ENGLISH II
Java I:	Hyrje në kurs Moduli 5: Arti – Teatri / Filmi / TV / Librat/ Media; formimi i fjalëve; trajtat veprorë-pësore; përemrat
Java II:	Marrja efektive e shënimeve në konferenca për shtyp; mendim kritik; diskutim
Java III:	Intervistë radioje; krahasim; pëlqime/mospëlqime; përshkrim filmash/libra; mbiemrat e vecante dhe ushtrime klasore
Java IV:	Moduli 6 – Ushqimi dhe Shëndeti Fjalë të përbëra (phrasal verbs) për sëmundje, ushqim, lëndime; formimi i fjalëve; fjalitë kushtore; ushtrime në klasë
Java V:	Si të hartohen dialogjet dhe monologjet; Shkrimi i një eseje pro dhe kundër Shqiptimi dhe theksi i fjalëve; ushtrime me shkrim
Java VI:	Përgatitja e prezantimeve mbi tema / filma / libra të zgjedhura; Vetëvlerësimi dhe vlerësimi në grup
Java VII:	Moduli 7 – Lexim i teksteve mbi historinë, qytetërimin dhe shkencën Prezantime për temat: njerëz, vende, ngjarje dhe objekte; Lloje të fjalëve specifike me fokus në ndajfolje
Java VIII:	Shkrimi i eseve; vlerësimi i eseve opinionistikë dhe eseve pro dhe kundër Shkrimi i një raporti tematik; përgatitje për test / kollokfium
Java IX:	Prezantimet e studentëve Komentet mbi prezantimet / vlerësimi formativ dhe pritjet

Java X:	Marrja e shënimeve dhe aftësitë analitike; fazat e të shkruarit – teknika "5 Ps"
Java XI:	Moduli 8 – Leximi i temave të arsimit; të folurit me fjalor specifik/ diskutimi dhe teknikat e dëgjimit të kujdesshëm për prezantim efektiv
Java XII:	Të lexuarit dhe të shkruarit e temave pararendëse / prezantimi i detyrave të shkruara
Java XIII:	Testimi intermediar
Java XIV:	Foljet ndihmëse (modal verbs); të bërit deduksione/ supozime Përmbledhje e ligjeratave rreth shkrimit të eseve
Java XV:	Përsëritje e moduleve 4–8; vlerësim formativ; rezultatet e pikëve Përgatitje për provimin përfundimtar

Politikat akademike dhe kodi i sjelljes

Studenti/ja është i/e obliguar t'i ndjekë ligjëratat dhe ushtrimet; nëse mungon më shumë se tri orë, do të bëhet një vlerësim pasues. Kodi i sjelljes aplikohet për të dyja palët, studentët dhe profesorin; gjatë orëve studentët duhet të marrin pjese në mënyrë aktive. Plagjiatura dhe kopjimi në provime ndëshkohen.